




|   |                      |
|---|----------------------|
| REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO                             |                      |
| AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT<br>AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE<br>ANTI-CORRUPTION AGENCY |                      |
| Dep. 2-D/DPK  | Nr. Prot. 01-3998/15 |
| Dep. 03   | Bi Prot. Prot No.    |
| Nr. f. faq.   | Data                 |
| Broj. stranica  | Datum                |
| Nr. pages   | Date 09.11.2015      |
| PRISHTINE   |                      |



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT  
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE  
ANTI – CORRUPTION AGENCY

|                        |   |
|------------------------|---|
| DATË/A:                | 09/11/2015  |
| REFERENC-Ë:            | AKK- DPK- DPKPP – 03-03/3896/15   |
| PËR/ZA/TO:             | z. Arif ZHUSHI<br>U.d Drejtor i Prokurimit Ministria e Infrastrukturës                          |
| CC:                    | z. Mustafë GARA<br>U.d. Sekretar i Përgjithshëm – Ministria e Infrastrukturës                   |
| NGA/OD/FROM:           | Hasan PRETENI,<br>Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit                                       |
| TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT: | Opinion lidhur me tenderin: “Shërbimet e Servisimit dhe Mirëmbajtjes së Kompjuterëve dhe L.Top” |



I nderuar z. ZHUSHI,

Në mbështetje të nenit 5 paragrafi 1 nën paragrafi 1.12 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë Kundër Korrupsionit dhe nenit 19 paragrafi 1 nën paragrafi 1.6 të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, lidhur me Tenderin: “Shërbimet e Servisimit dhe Mirëmbajtjes së Kompjuterëve dhe L.Top” me numër prokurimi: MI/15/054/236, Agjencia kundër Korrupsionit, ofron këtë:

OPINION

Në lidhje me Tenderin Publik: “Shërbimet e Servisimit dhe Mirëmbajtjes së Kompjuterëve dhe L.Top” me numër prokurimi: MI/15/054/236, në mënyrë që të procedohet në pajtim me dispozitat përkatëse të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04-L/042.

## A r s y e t i m

Duke u nisur nga fakti se ka dyshime të bazuara, Agjencia kundër Korrupsion ka autorizuar fillimin e procedurës për parandalimin e korrupsionit në prokurim publik për aktivitetin: “Shërbimet e Servisimit dhe Mirëmbajtjes së Kompjuterëve dhe L.Top”. Pas ekzaminimit të dokumentacionit të nevojshëm, të vënë në dispozicion nga Autoriteti Kontraktues, Agjencia ka ardhur në konstatimet e më poshtme.

Autoriteti Kontraktues, Ministria e Infrastrukturës, bazuar në nevojën për servisimin dhe mirëmbajtjen e kompjuterëve dhe laptopëve, ka paraparë aktivitet prokurimi, shërbime, vlerë e ulët, kuotim çmimi dhe në të njëjtën kohë tek lloji i procedurës, e ka cilësuar procedurë “E hapur”. Aktiviteti i prokurimit në Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik është shpallur më datë: 27/10/2015. Agjencia kundër Korrupsion ka dyshime të bazuara se Ministria e Infrastrukturës nuk po zbaton legjislacionin e prokurimit publik për këtë aktivitet prokurimi, mos zbatim i cili mund të shpie në shpërbllim me kontratë në baza jo meritore.

Ministria e Infrastrukturës, si Autoritet Kontraktues gjatë përpilimit të dosjes së tenderit nuk ka dhënë vëmendjen e duhur, ku edhe janë bërë disa shkelje që bien ndesh me legjislacionin për Prokurim Publik.

Në Njoftim për Kontratë, në faqen 2 tek Kohëzgjatja e kontratës publike kornizë është paraqitur afati: “në vite 2 ose muaj 24”, ndërsa tek tabela e Dosjes së tenderit një gjë e tillë nuk figuron. Nëse aktiviteti përkatës i prokurimit kërkon publikimin e njoftimit të kontratës, dosja e tenderit duhet të përmbajë një kopje të njoftimit të tillë dhe informatat e tjera të tilla përkatëse që mund të jenë të nevojshme për të qartësuar dhe plotësuar informatat që gjinden në njoftimin e tillë. Nëse Autoriteti Kontraktues e ka cilësuar këtë kontratë si “Kontratë Kornizë” dhe në të njëjtën kohë është edhe “Kuotim Çmimi” atëherë këtu ka mospërputhje në lidhje me atë se çmimi final i kontratës kornizë parashikohet por nuk dihet saktë, ndërsa “Kuotimi i Çmimit” duhet të qartësohet saktë vlera e kontratës. Kuotimi i Çmimit duhet të përmbajnë një shumë të përgjithshme të çmimit të saktë që autoriteti kontraktues duhet ta paguajë në mënyrë që të marrë mallrat ose shërbimet përkatëse.

Në Dosjen e Tenderit “Shërbimet e Servisimit dhe Mirëmbajtjes së Kompjuterëve dhe L.Top” tek pika 8.1 “Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare” ju si Autoritet Kontraktues keni kërkuar që: “Vlera e përgjithshme monetare e shërbimeve të ekzekutuara në lëmin e mirëmbajtjes dhe servisimit të IT-së, në tre vitet e fundit për operatorin ekonomik ose grupin e operatorëve ekonomik jo më e vogël se 20,000.00 €.” Autoriteti Kontraktues mund të kërkoj që Operatori Ekonomik ose Grupi i Operatorëve Ekonomik të ketë realizuar punët e natyrës së ngjashme, edhe atë mund ta kërkoj për periudhën e tre viteve të fundit duke i vendosur edhe një vlerë të caktuar të projekteve, por vlera e tillë nuk mund të tejkaloj 1.5 herë vlerën e parashikuar të kontratës.

Në Dosjen e Tenderit “Shërbimet e Servisimit dhe Mirëmbajtjes së Kompjuterëve dhe L.Top” tek pika 9.1 “*Kërkesat mbi mundësinë teknike dhe/ose profesionale*”, ju si Autoritet Kontraktues keni kërkuar që: “*Bartësi kryesor i projektit të ketë mbi 60% të vlerës së projektit*”. Autoriteti Kontraktues nuk mund të kufizoj në përqindje vlerën e projektit mes operatorëve ekonomik. Operatorët ekonomik i bashkojnë kapacitetet e tyre dhe veprojnë si një trup në tender.

Po ashtu, në Dosjen e Tenderit “Shërbimet e Servisimit dhe Mirëmbajtjes së Kompjuterëve dhe L.Top” tek pika 13.1 “*Siguria e Tenderit*” ju si Autoritet Kontraktues keni kërkuar që: “Vlera e sigurisë së tenderit 300.00 €”. Vlera e kërkuar nga Autoriteti juaj nuk është në përputhje me ligjin. Nëse autoriteti kontraktues vendos që të detyrojë depozitimin e sigurisë së tenderit, shuma e sigurisë së tillë duhet të jetë jo më pak se tre për qind dhe jo më shumë se pesë për qind e vlerës së parashikuar të kontratës publike, por sidoqoftë, në asnjë rast nuk duhet të jetë më pak se njëmijë Euro.

Veprimet e Autoritetit Kontraktues konsiderojmë që bien ndesh me, nenin 27 Dosja e Tenderit; Nenin 36 Procedurat për kuotimin e çmimeve; Nenin 57 Sigurimi i Tenderit; dhe Nenin 71 Grupet e Operatorëve Ekonomik dhe Operatorët e Huaj Ekonomik të Ligjit për Prokurimin Publik dhe UA-02/2014.

Konsiderojmë se shkelje të tilla nuk duhet lejuar në procedura të prokurimit, andaj Agjencia kundër Korrupsionit rekomandon anulimin e kësaj procedure të prokurimit dhe kërkon nga Autoriteti Kontraktues që t’i shmang praktikat e tilla në të ardhmen.

Autoritetet Kontraktuese e informojnë Agjencinë për veprimet e ndërmarra.

Me respekt !